

EPPC Albania kërkon një **Key Account** për klientin e saj, një ndër kompanitë lider në tregun e produkteve promociionale, veshjeve të punës dhe pajisjeve të mbrojtjes personale në punë dhe printimeve dixhitale.

Si Key Account, do të keni përgjegjësi për menaxhimin e marrëdhënieve me klientët kryesorë të kompanisë, duke siguruar një shërbim të shkëlqyer, përmbushjen e objektivave të shitjes dhe optimizimin e mundësive për zhvillim të biznesit.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Monitoron performancën e portofolit të klientëve dhe siguron mbështetje për përmirësimin e rezultateve;
- Planifikon dhe organizon takimet me klientët kyç për të optimizuar rezultatet e shitjeve dhe marrëdhëniet me ta;
- Zhvillon dhe mirëmban marrëdhënie të forta me klientët ekzistues dhe potencialë brenda portofolit të tij/saj;
- Zbaton strategji të shitjes për arritjen e objektivave të caktuara;
- Trajton dhe zgjidh ankesat dhe shqetësimet e klientëve në mënyrë profesionale dhe efikase;
- Siguron që të gjitha aktivitetet e shitjes dhe komunikimi me klientët të jenë në përputhje me politikat dhe procedurat e kompanisë;
- Kur është e nevojshme, bashkëpunon me departamentet e tjera për prioritetizimin e kërkesave të klientëve;
- Merr pjesë në trajnime të rregullta për produktet dhe shërbimet e ofruara për të përmirësuar njohuritë & aftësitë në shitje;
- Përgatit raporte të rregullta mbi aktivitetet dhe performancën e shitjeve dhe marrëdhënieve me klientët.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare;
- Përvojë në **pozicione të ngjashme të mëparshme në shitje B2B**;
- Të ketë iniciativë, të jetë fleksibël, i aftë të punoj i pavarur dhe të orientohet drejt rezultateve;
- **Aftësi të mira komunikuese, negociuese dhe organizative**;
- **Të ketë leje drejtimi automjeti**;
- Të zotërojë mirë MS Office.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni aplikimin tuaj duke ndjekur linkun:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.